

VENDIM
Nr.20, datë 1.6.2011

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Anëtar	i	Gjykatës Kushtetuese, kryesues i seancës
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“ “
Petrit Plloçi	Anëtar	i	“ “
Vitore Tusha	Anëtare	e	“ “
Sokol Sadushi	Anëtar	i	“ “
Sokol Berberi	Anëtar	i	“ “
Admir Thanza	Anëtar	i	“ “
Altina Xhoxhaj	Anëtare	e	“ “

me sekretare Blerina Çinari, në datë 23.2.2011 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 46/31 Akti që i përket:

KËRKUES: Arben Xheraj, i përfaqësuar nga avokati Dilaver Bengasi

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. Prokuroria e Përgjithshme, në mungesë.
2. Avokatura e Shtetit, përfaqësuar nga Abaz Deda.

OBJEKTI: 1. Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.1042, datë 9.7.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

2. Pushimi i vendimit nr.417, datë 20.6.2001 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

3. Të urdhërohen institucionet shtetërore të zbatojnë vendimin e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut të datës 29.7.2008, me palë shtetasin Arben Xheraj, kundër Republikës së Shqipërisë.

4. Pezullimi i vendimit nr.417, datë 20.6.2001 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë deri në hyrjen në fuqi të vendimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Nenet 131/f, 134/g dhe 142/3 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Vladimir Kristo, kërkuesin që kërkoi pranimin e kërkesës, palën e interesuar, Avokatura e Shtetit që kërkoi pranimin e kërkesës dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Kërkuesi Arben Xheraj, me vendimin nr.191, datë 23.10.1996 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Durrësit, është dënuar me burgim të përjetshëm për veprën penale të parashikuar nga neni 78 i Kodit Penal, vrasje me paramendim.

Me vendimin nr.1106, datë 27.11.1996 Gjykata e Apelit të Durrësit ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Durrësit dhe e ka dënuar kërkuesin me 20 vjet burg për veprën penale të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal, vrasje me dashje.

Mbi bazën e kërkesës për rishikim të kërkuesit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Durrësit, me vendimin nr.4/60, datë 14.12.1998 ka prishur vendimet e mëparshme dhe ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes penale në ngarkim të kërkuesit, pasi ky i fundit nuk e kishte kryer veprën penale për të cilën akuzohej.

Me vendimin nr.74, datë 21.10.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Durrësit është vendosur pranimi i kërkesës së prokurorit për rivendosjen në afat të ankimit për në Gjykatën e Apelit të Durrësit.

Me vendimin nr.244, datë 15.12.1999 të Gjykatës së Apelit të Durrësit është vendosur mospranimi i ankimit të Prokurorit të Apelit të Durrësit kundër vendimit penal nr.4/60, datë 14.12.1998 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Durrësit.

Me vendimin nr.121, datë 19.4.2000 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është vendosur prishja e vendimit nr.244, datë 15.12.1999 të Gjykatës së Apelit të Durrësit për sa i përket mospranimit të ankimit të prokurorit dhe kthimi i akteve për rishqyrtim në atë gjykatë.

Me vendimin nr.267, datë 18.12.2000 të Gjykatës së Apelit të Durrësit është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr.4/60, datë 14.12.1998 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Durrësit që ka vendosur pushimin e

gjykimit të çështjes penale në ngarkim të kërkuesit, i akuzuar për veprën penale të vrasjes, pasi ky i pandehur nuk e kishte kryer veprën penale për të cilën akuzohej.

Me vendimin nr.417, datë 20.6.2001 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është vendosur prishja e vendimit nr.267, datë 18.12.2000 të Gjykatës së Apelit të Durrësit dhe nr.4/60, datë 14.12.1998 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Durrësit dhe, pushimi i gjykimit të çështjes. Ky vendim përfundimisht ka lënë në fuqi vendimin nr.191, datë 23.10.1996 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Durrësit dhe nr.1106, datë 27.11.1996 të Gjykatës së Apelit të Durrësit, të cilat e deklarorin fajtor kërkuesin për krimin e vrasjes me dashje, të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal.

Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e vendimeve nr.74, datë 21.10.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Durrësit dhe nr.417, datë 20.6.2001 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, me vendimin nr.80, datë 26.4.2002, ka vendosur moskalimin e çështjes në seancë plenare.

Më pas, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), e cila ka vërejtur se vendimi i pafajësisë, dhënë me vendimin e datës 14.12.1998 ndaj aplikantit ka marrë formë të prerë më 24.12.1998. Kërkesa e prokurorit për të apeluar jashtë afatit ligjor vendimin e pafajësisë dhe pranimi i kësaj kërkesë, duke i dhënë të drejtë prokurorit për rivendosje në afat të ankimit, ka sjellë shkeljen nga Gjykata e Lartë të parimit të sigurisë juridike, sipas nenit 6/1 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ).

GJEDNJ-ja ka vlerësuar se argumentet e përdorura nga prokurori, për të justifikuar kërkesën për apelim jashtë afatit ligjor 10-ditor, kanë qenë të pamjaftueshme për të ligjëruar kundërshtimin e vendimit të formës së prerë dhe përdorimin e këtij mjeti të jashtëzakonshëm. Gjithashtu, GJEDNJ-ja ka pranuar se argumentet e përdorura nga Qeveria se apeli nuk mund të depozitohet brenda afatit, pasi prokurori që mori pjesë në procedurat e dhënies së pafajësisë (i njëjti që kishte marrë pjesë edhe në procedurat që kishin çuar në fajësimin e kërkuesit) nuk i kishte njoftuar eprrorët e tij, janë të papranueshme. Rreziku i ndonjë gabimi të bërë nga autoritetet proceduese ose nga një gjykatë duhet të mbahet nga shteti dhe gabimet nuk duhet të kompensohen në dëm të individit në fjalë.

GJEDNJ-ja ka konsideruar se pranimi i kërkesës së prokurorit nuk ka vendosur drejtpeshimin midis interesit të kërkuesit dhe nevojës për të garantuar një efikasitet të sistemit të drejtësisë penale.

Si përfundim, sipas kësaj gjykate, mënyra e duhur për rivënien në vend të të drejtës së shkelur të aplikantit do të ishte rikonfirmimi nga autoritetet përkatëse i vendimit të 14 dhjetorit 1998, ku është vendosur pranimi i kërkesës së kërkuesit dhe pushimi i çështjes, sepse ai nuk e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Pas dhënies së vendimit nga GJEDNJ-ja, me datë 6.1.2010 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke pretenduar pavlefshmërinë e vendimit nr.417, datë 20.6.2001 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së, të datës 29.7.2008. Sipas kërkuesit, vendimi nr.417, datë 20.6.2001 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është i pavlefshëm sepse, për efekt të mangësive ligjore që ekzistojnë në legjisllacionin penal shqiptar vendimet e GJEDNJ-së, ende nuk njihen si përfundimtare dhe pjesë e sistemit të brendshëm juridik nga institucionet shqiptare. Në këtë kuadër, ai ka kërkuar nga Gjykata Kushtetuese njohjen e pafajësisë për veprën penale të vrasjes dhe ekzekutim të vendimit të Gjykatës Europiane.

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, me vendimin nr.22, datë 9.3.2010, vendosi mospranimin e kërkesës, duke përcaktuar se organi shtetëror kompetent për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga vendimi i sipërpërmendur i GJEDNJ-së është Gjykata e Lartë.

Me vendimin nr.00-2010-1042, datë 9.7.2010, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pasi mori në shqyrtim çështjen penale nr.00797 në ngarkim të shtetasit Arben Xheraj, vendosi mospranimin e kërkesës për rishikimin e vendimit nr.417, datë 20.6.2001 të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi

Kërkuesi ka pretenduar para Gjykatës Kushtetuese se, në përputhje me nenin 46 të KEDNJ-së, shtetet palë janë të detyruara të zbatojnë vendimet e GJEDNJ-së. Për sa më sipër, në përputhje edhe me vendimin e sipërcituar të kësaj Gjykate, me palë kërkuesin Arben Xheraj, në kushtet e konstatimit të një procesi të parregullt ligjor, lipset që autoritetet gjyqësore të Republikës së Shqipërisë, të shmangin çdo pengesë ligjore, për të garantuar lirinë vetjake të kërkuesit, duke e shpallur të pafajshëm. Kërkuesi pretendon se vendimet e GJEDNJ-së janë pjesë e sistemit të brendshëm juridik të Republikës së Shqipërisë dhe, për rrjedhojë, duhen zbatuar nga gjithë aktorët shtetërorë, përfshirë këtu autoritetet gjyqësore.

Kërkuesi ka kërkuar, gjithashtu, nga Gjykata Kushtetuese që deri në hyrjen në fuqi të vendimit përfundimtar të saj, të pezullojë vendimin nr.417, datë 20.6.2001 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Për këtë kërkesë, Gjykata Kushtetuese, më datë 23.2.2011, ka vendosur pezullimin e vendimit nr.417, datë 20.6.2001 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si dhe të vendimeve nr.191, datë 23.10.1996 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Durrësit dhe nr.1106, datë 27.11.1996 të Gjykatës së Apelit të Durrësit.

Pala e interesuar, Avokatura e Shtetit, ka mbështetur pretendimet e kërkuarit duke parashtruar të njëjtat argumente.

II

Për kërkesën për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr.1042, datë 9.7.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

Me vendimin nr.00-2010-1042, datë 9.7.2010, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në Dhomën e Këshillimit ka hedhur poshtë kërkesën e shtetasit Arben Xheraj për rishikimin e vendimit nr.417, datë 20.6.2001 të Gjykatës së Lartë, me arsyetimin se kërkesa nuk përmban kushtet e parashikuara nga neni 450/a i Kodit të Procedurës Penale, i cili vendos si parakusht për rishikimin e një vendimi penal, ndryshimin ndërmjet fakteve mbi të cilat bazohet vendimi i ankimuar dhe fakteve të provuara në një tjetër vendim gjyqësor. Gjithashtu, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë konsideron se fakti që GJEDNJ-ja ka konstatuar një shkelje të të drejtës për një proces të rregullt ligjor ndaj shtetasit të sipërpërmendur, përbën një indicie për nisjen e një gjykimi kushtetues dhe jo rishikues.

Gjykata Kushtetuese (Gjykata) konstaton se interpretimi i bërë nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është i gabuar dhe vjen në kundërshtim me nenet 122 e 124 të Kushtetutës si dhe me nenin 46 të KEDNJ-së.

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, me vendimin nr.22, datë 9.3.2010, vendosi të shpallte moskompetencën dhe të drejtonte kërkuarin në Gjykatën e Lartë, si institucioni i vetëm përgjegjës dhe kompetent për të përmbushur detyrimet që burojnë nga vendimi i GJEDNJ-së, konkretisht rishikimin e vendimeve të mëparshme gjyqësore të formës së prerë në ngarkim të kërkuarit dhe rikonfirmimin e vendimit të 14 dhjetorit 1998 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Durrësit, me të cilin ishte vendosur pranimi i kërkesës së tij për pushimin e çështjes, me arsyetimin se nuk e kishte kryer veprën penale për të cilën akuzohej.

Në këtë vendim Gjykata arsyeton, ndër të tjera, se vendimet e GJEDNJ-së janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës, palë të KEDNJ-së, duke përmbushur në këtë mënyrë zotimet që burojnë nga neni 46/1 i saj. Gjykata, konstaton, gjithashtu, se krahas domosdoshmërisë së plotësimit nga Kuvendi të boshllëkut ligjor në legjislacionin penal procedural, Gjykata e Lartë duhet të bëjë përpjekje për të gjetur zgjidhjen e duhur, për të vënë në vend të drejtën e shkelur të kërkuarit, qoftë duke përdorur edhe analogjinë me Kodin e Procedurës Civile.

Në kundërshtim me sa pretendohet në vendimin nr.00-2010-1042, datë 9.7.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, Gjykata çmon se, siç rezulton dhe nga përmbajtja e nenit 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", një vendim i mundshëm i Gjykatës, që do të shfuqizonte vendimin nr.417, datë 20.6.2001 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, duke lënë mënjane problemet që lidhen me juridiksionin, do të kishte si pasojë, gjithsesi, rishqyrtimin e çështjes nga Gjykata e Lartë. Në këto kushte, një vendim i tillë i Gjykatës Kushtetuese, në kuptimin e mësipërm do të kishte më shumë vlerë formale deklarative se sa funksionale, sepse nuk do të bënte gjë tjetër vetëm se do të konfirmonte atë që ka bërë dhe vendimi i GJEDNJ-së, konstatimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike.

Gjykata, në vijim të argumenteve të saj, e sheh me vend të theksojë se, për trajtimin e të drejtave themelore të njeriut, GJEDNJ-ja ka në sistemin tonë juridik një kompetencë ekskluzive. Kjo kompetencë është e pranuar nga sistemi ynë i brendshëm juridik, për efekt të zbatimit të nenit 122 të Kushtetutës, po edhe të nenit 17/2 të saj, të cilët sjellin si detyrim që vendimet e GJEDNJ-së të zbatohen drejtpërsëdrejti.

Me rastin e ratifikimit të KEDNJ-së Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, si përfaqësues i sovranitetit popullor, ka marrë përsipër detyrimet, të cilat janë të zbatueshme nga të gjitha organet shtetërore të Republikës së Shqipërisë, përfshirë gjykatat e të gjitha niveleve, pavarësisht llojit të tyre. Për sa më sipër, detyrimet që mbartin secili nga pushtetet për zbatimin e vendimeve përfundimtare të GJEDNJ-së janë të ndryshme. Nëse për ekzekutivin janë menjëherë të ravigjueshme këto detyrimet, si p.sh. në rastin e pagimit të dëmshpërblimeve të imponuara nga GJEDNJ-ja, për sa i përket dy pushteteve të tjera ka vend për interpretim.

Posaçërisht për sa i përket vendimeve të GJEDNJ-së për procedime penale, për legjislativin lind nevoja që të marrë masa për të harmonizuar legjislacionin e brendshëm me dispozitat e KEDNJ-së. Nëse nuk ka harmonizim pra, nëse jemi në rastet e vakumit legjislativ, ose kur parashikimet ligjore bien në kundërshtim me dispozitat e Konventës, atëherë gjyqtarët e çdo niveli zbatojnë drejtpërsëdrejti vendimet e

GJEDNJ-së në përputhje me nenin 122 të Kushtetutës dhe nenet 19 dhe 46 të KEDNJ-së. Neni 122 i Kushtetutës përcakton shprehimisht se dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare kanë epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të.

Në rastin në shqyrtim, GJEDNJ-ja ka konstatuar se rivendosja në afat e prokurorit për të bërë ankim ndaj vendimit nr.244, datë 15.12.1999 të Gjykatës së Apelit të Durrësit, që shpallte të pafajshëm kërkuesin, ka cenuar parimin e sigurisë juridike, duke i mohuar atij pritshmërinë e ligjshme se vendimi nr.4/60 datë 14.12.1998 i Gjykatës së Apelit të Durrësit nuk mund të ndryshohej nëpërmjet ankimit në një gjykatë më të lartë, pasi kishin kaluar afatet e ankimit. Për pasojë, vendimi nr.417, datë 20.6.2001 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që shfuqizon vendimin e Gjykatës së Apelit të Durrësit, i cili deklaronte të pafajshëm kërkuesin, është marrë në kushtet e cenimit të parimit të sigurisë juridike.

Në këto rrethana lind detyrimi për organet shtetërore të Republikës së Shqipërisë, në rastin konkret të Gjykatës së Lartë, që të shmangin pasojat e paligjshme që kanë ardhur nga prishja e vendimit të sipërpërmendur të Gjykatës së Apelit të Durrësit. Zbatimi i vendimit të GJEDNJ-së duhet të kryhet në mënyrën më efikase të mundshme dhe duke mos cenuar një element të rëndësishëm të të drejtës për një proces të rregullt ligjor, pikërisht kohëzgjatjen e paarsyeshme të procesit.

Gjykata Kushtetuese çmon se respektimi i KEDNJ-së dhe standardeve kushtetuese është detyrim jo vetëm i saj, por edhe i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, në mënyrë të veçantë Gjykatës së Lartë për shkak të kompetencave të veçanta të saj të natyrës rishikuese, por edhe në drejtim të unifikimit të praktikës gjyqësore.

Siç është shprehur edhe GJEDNJ-ja: “Roli i një gjykate të lartë në një palë kontraktuese është pikërisht zgjidhja e konflikteve, shmangia e divergjencave dhe qëndrueshmëria. Në fakt në çështjen në shqyrtim vetë Gjykata e Lartë u bë burimi i pasigurisë duke minuar besimin publik te sistemi ligjor dhe shteti i së drejtës” (*Shih Çështja Mullai dhe të tjerët kundër Shqipërisë, paragrafi 83*).

Gjykata çmon se duke pasur parasysh edhe rolin qendror të Gjykatës së Lartë në sistemin tonë gjyqësor, lipset që kjo gjykatë, në përputhje edhe me nenin 1 të Kodit të Procedurës Penale, të mos kufizohet vetëm në dispozitat e këtij Kodi, por të zbatojë drejtpërsëdrejti Kushtetutën dhe KEDNJ-në.

Gjykata vëren se qëllimi i gjykimit kushtetues në lidhje me të drejtën për një proces të rregullt ligjor është të evidentojë shkelje të mundshme të kësaj të drejte. Në kushtet kur nga GJEDNJ-ja janë konstatuar shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor ndaj kërkuesit, për shkak të kompetencës ekskluzive të GJEDNJ-së në këtë drejtim, ky fakt nuk mund të vihet në diskutim. Qëllimi i procesit kushtetues në këtë rast është që të shfuqizojë ato vendime gjyqësore që kanë sjellë cenim të kësaj të drejte dhe t'i japë mundësi organeve gjyqësore, të veprojnë në përputhje me vendimet e GJEDNJ-së, me qëllim që të arrihet mbrojtja efektive e të drejtave të individit, në rastin konkret siguria dhe liria e tij vetjake.

Për sa më sipër, në një rast të ngjashëm, në të njëjtat përfundime ka arritur edhe Gjykata Kushtetuese Italiane. Sipas kësaj Gjykate: “Në lidhje me një të drejtë themelore, respektimi i detyrimeve ndërkombëtare nuk mundet asnjëherë të jetë shkak i një zvogëlimi të mbrojtjes së saj në krahasim me ato të parashikuara tashmë nga rendi i brendshëm, por mund dhe duhet, përkundrazi, të përbëjë instrument efikas të zgjerimit të vetë mbrojtjes. Nëse merret kjo si pikënisje në shqyrtimin e marrëdhënies së ndërmjetme normative midis niveleve të ndryshme të garancive, arrihet lehtësisht në përfundimin, se vlerësimi përfundimtar në lidhje me forcën efektive të mbrojtjes në raste të veçanta është fryt i një kombinimi virtuoz ndërmjet detyrimit që bie mbi ligjvënësin kombëtar për t'u përshtatur me parimet e vendosura nga GJEDNJ-ja, në interpretimin e saj gjyqësor, detyrim që në të njëjtën mënyrë bie mbi gjyqtarin e zakonshëm që t'i japë normave të brendshme një interpretim në përputhje me parimet e Konventës, dhe detyrimin që në fund bie mbi Gjykatën Kushtetuese – në hipotezën e pamundësisë së një interpretimi pajtues – që të mos lejojë të vazhdojë të ketë vlerë ligjore në sistemin juridik italian, një normë për të cilën është vërtetuar deficieti (mungesa, pamjaftueshmëria) i mbrojtjes në lidhje me një të drejtë themelore. Për më tepër, neni 53 i vetë KEDNJ-së përcakton se interpretimi i dispozitave të KEDNJ-së nuk mund të përmbajë nivele mbrojtjeje inferiore nga ato të siguruar nga burimet kombëtare.” (*Shih vendimin nr.317, datë 30.11.2009*)

Interpretimi i Gjykatës së Lartë, se vendimet e GJEDNJ-së nuk janë të barasvlershme me vendimet e gjykatave shqiptare, bie në kundërshtim edhe me nenin 10 të Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon se marrëdhëniet me autoritetet e huaja në fushën penale rregullohen nga marrëveshjet ndërkombëtare të pranuar nga shteti shqiptar, nga parimet dhe normat përgjithësisht të pranuar të së drejtës ndërkombëtare, si edhe dispozitat e këtij Kodi.

Duke pasur parasysh, veç të tjerave, edhe dispozitën e sipërpërmendur, Gjykata çmon se për sa i përket institutit të rishikimit nuk mund të pretendohet se vendimet, të cilave u referohet neni 450/1/a, janë vetëm ato të dhëna nga gjykatat e Republikës së Shqipërisë, pasi neni 10 i Kodit të Procedurës Penale në mënyrë eksplicite detyron gjykatat që të zbatojnë dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare në të cilat

Republika e Shqipërisë është palë.

Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se vendimi nr.00-2010-1042, datë 9.7.2010 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim të vendimit nr.417, datë 20.06.2001 të Kolegjit Penal të kësaj gjykate, vjen në kundërshtim me Kushtetutën dhe KEDNJ-në dhe, si i tillë, duhet shfuqizuar.

III

Për kërkesën për pushimin e vendimit nr.417, datë 20.6.2001 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

Gjykata konsideron se kërkesa e bërë para saj nga kërkuesi për pushimin e vendimit nr.417, datë 20.6.2001 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe rikonfirmimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Durrësit që vendos pushimin e gjykimin të çështjes me arsyetimin se ai nuk e kishte kryer veprën penale, për të cilën akuzohej, del jashtë juridiksionit të kësaj Gjykate. Nuk është atribut i Gjykatës pushimi i çështjeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe për më tepër shpallja si të pafajshëm e personave të gjykuar nga këto gjykata. Për këto arsye, kërkesa në këtë pjesë të saj duhet rrëzuar si e pabazuar.

IV

Për fuqinë detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese

Mospranimi i kërkesës për rishikim të vendimeve nga ana e Kolegjit Penal, në kushtet kur një vendim i Gjykatës Kushtetuese ka përcaktuar Gjykatën e Lartë si organin e përshtatshëm për korrigjimin e pasojave që kanë ardhur nga shfuqizimi i vendimit nr.4/60, datë 14.12.1998 të Gjykatës së Apelit të Durrësit, ngre, gjithashtu, probleme në lidhje me cenimin e fuqisë detyruese që kanë vendimet e Gjykatës. Në jurisprudencën e saj kjo Gjykatë ka vlerësuar se zbatimi i detyrueshëm i vendimeve të saj është i garantuar nga Kushtetuta, e cila në nenin 132 dhe 145 të saj sanksionon shprehimisht këtë koncept kushtetues. Vendimet e Gjykatës kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Ato përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe, për rrjedhojë, kanë efektet e *forcës së ligjit*.

Ndikimi i padiskutueshëm i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është i tillë që iu imponon të gjithë organeve shtetërore, duke mos përjashtuar as gjykatat, fuqinë detyruese të arsyetimit të vendimit të saj. Arsyetimi që përdor Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj ka forcën e ligjit, çka buron nga autoriteti i këtij organi për të thënë fjalën e fundit, në çështjet për të cilat të tjerët tashmë janë shprehur. Çdo qëndrim i kundërt krijon një precedent të rrezikshëm në marrëdhëniet institucionale (*Shih vendimin nr.5 datë 7.2.2001 të Gjykatës Kushtetuese*).

Siç ka theksuar Gjykata edhe në vendimin e sipërcituar, veçanërisht në rastet kur bëhet fjalë për të drejtat themelore të njeriut, interpretimi përfundimtar i normës kushtetuese është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese. Nëse kjo e fundit, me vendim, përcakton se një proces gjyqësor i ka cenuar shtetasit të drejtat themelore, duke caktuar edhe detyra për gjykatat gjatë rigjykimin të çështjes konkrete, moszbatimi i këtyre detyrave automatikisht sjell një cenim të të drejtave themelore, në rastin konkret të të drejtës për një proces të rregullt ligjor, të sanksionuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së.

Nisur nga tagrat që i jep neni 124 i Kushtetutës, roli dhe funksioni i Gjykatës Kushtetuese është që nëpërmjet vendimeve të transformojë dispozitat kushtetuese nga abstrakte-metafizike, në substanciale dhe konkrete, duke i garantuar mbrojtje kushtetuese situatave juridike në të cilat ndodhen individët. Për shkak të vetë formës ekstremisht konçize që kanë dispozitat kushtetuese, nëpërmjet vendimeve, pra interpretimit që bën Gjykata, bëhet e mundur që Kushtetuta të jetë “e gjallë”, që do të thotë se Gjykata i përshtatet evolucionit që bëjnë vlerat në vendin tonë, duke garantuar që vlera të reja, të cilat ndoshta nuk ishin në vëmendje të hartuesve të Kushtetutës, të marrin dinjitet, njohje dhe, mbi të gjitha, mbrojtje kushtetuese. Për vetë faktin se norma kushtetuese bëhet realitet gjatë interpretimit, pra gjatë procesit vendimmarrës të Gjykatës, e bën këtë të fundit pa diskutim burim të së drejtës, për më tepër e bën atë një burim parësor të saj, duke pasur parasysh se neni 4 i Kushtetutës parashikon se Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë.

Në këtë kuptim mund të themi se Gjykata ka dy funksione themeltare: atë shtytës-evolutiv të përshkruar më sipër, i cili shpesh është rrjedhojë e vlerës që kanë vendimet e GJEDNJ-së, dhe faktit se Gjykata mund të përdorë në mbështetje të arsyetimeve të veta qëndrimet që kanë mbajtur Gjykatat homologe europiane dhe më gjerë dhe, nga ana tjetër, funksionin mbrojtës-konservativ, duke garantuar pandryshueshmërinë e mbrojtjes kushtetuese për ato vlera që konsiderohen si kryesore nga populli i Republikës së Shqipërisë, vullnetin e të cilit interpreton Gjykata Kushtetuese. Të dyja këto funksione janë njëherazi të rëndësishme dhe të barasvlefshme.

Nëse Gjykata ka çmuar se një shtetasi të caktuar i janë cenuar të drejtat e veta kushtetuese, siç ka

bërë në vendimin e saj nr.22, datë 9.3.2010, ky fakt nuk mund t'i nënshtrohet një procesi vlerësimi nga askush, aq më pak nga Gjykata e Lartë, e cila ka për detyrë të garantojë zbatimin korrekt të ligjit penal, procedural dhe material nga të gjitha gjykatat, në përputhje me Kushtetutën dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese.

Për sa më sipër, zgjidhja e një konflikti ndërmjet dy vendimmarrjeve të ndryshme të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese ka vetëm një rrugë, e cila është shfuqizimi i vendimit të Gjykatës së Lartë nga Gjykata Kushtetuese. Një zgjidhje e ndryshme jo vetëm do të ishte antikushtetuese, pasi nuk do të respektohej një akt parësor, i nxjerrë pikërisht nga një burim parësor siç është Gjykata Kushtetuese, nga një organ i cili jo vetëm interpreton akte hierarkisht më të ulët se Kushtetuta, por nuk ka tagër të bëjë interpretimin përfundimtar të tyre në këndvështrimin kushtetues.

Gjykata rithekson se rreziku i një situatë të tillë qëndron jo vetëm në faktin se një individ i caktuar i cenohet e drejta kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, por edhe për faktin se preket vetë thelbi i funksionimit të shtetit të së drejtës, duke qenë se njëri prej pushteteve tejkalon pikërisht ato caqe që kushtetutbërësi i konsideron si të padhunueshme dhe në mbrojtje të të cilave ka parashikuar një organ të posaçëm siç është Gjykata Kushtetuese.

Për më tepër, nisur nga formulimi i nenit 17 të Kushtetutës, vihet në dyshim orientimi i Republikës së Shqipërisë si pjesëtare e bashkësisë së demokracive liberale europiane, të cilat pikërisht nëpërmjet një kontrate të re sociale kanë vendosur që një bashkësi të caktuar të drejtash, përfshirë të drejtën për një proces të rregullt ligjor, t'i konsiderojnë si të pacenueshme. Në rastin konkret dhunimi i të drejtës së individit për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga Kushtetuta, vjen pa ligj dhe, për më keq nga një organ i lartë gjyqësor, i cili, veç të tjerash, me qëndrime të kësaj natyre shton pasojat e dëmshme të një procesi tashmë të deklaruar joligjor si nga GJEDNJ-ja ashtu dhe nga kjo Gjykatë edhe me elemente të tjera, siç janë zvarritjet e paarsyeshme në zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

Gjykata, në përputhje me nenin 45/4 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash, vendosi gjithashtu të heqë masën e pezullimit.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 shkronja "a" dhe nenit 134 pika 1 shkronja "f" të Kushtetutës; neneve 72 dhe 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë":

VENDOSI:

- Shfuqizimin, njëzëri, të vendimit nr.1042, datë 9.7.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi).
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Rrëzimin, me shumicë votash, të kërkesës për pushimin e vendimit nr.417, datë 20.6.2001 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, për mungesë juridiksioni.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Vladimir Kristo (kryesues i seancës), Petrit Plloçi, Xhezair Zaganjori, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj

Anëtarë pjesërisht kundër: Sokol Berberi, Sokol Sadushi, Admir Thanza

MENDIM PAKICE

Nuk jemi dakord me shumicën për sa i takon rrëzimit të pretendimit të kërkuarit për pushimin e vendimit nr.417, datë 20.6.2001 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, për mungesë juridiksioni. Pavarësisht nga formulimi i kërkesës për pushimin e vendimit të sipërpërmendur, thelbi i saj nuk lidhet me marrjen përsipër nga Gjykata Kushtetuese të attributeve të gjykatave të zakonshme për shpalljen e pafajësisë, por me detyrimin e saj për t'i dhënë përgjigje pretendimit kryesor të kërkuarit për cenimin që i ka bërë ky vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë parimit të sigurisë juridike.

Pakica vlerëson se *Vendimi Xheraj kundër Shqipërisë* i Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) përbën një shkak të ri për këtë gjykim kushtetues. Kujtojmë se në këtë çështje GJEDNJ-ja, për cenimin e nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndër të tjera shprehet se rrethana të posaçme të çështjes mund të dëshmojnë se mënyra aktuale, në të cilën përdoret një rishikim, dëmton thelbin e një procesi të drejtë gjyqësor [para.53]. Megjithatë, më tej GJEDNJ-ja vlerëson se çështja që ngrihet është nëse, mbi bazën e fakteve të çështjes dhe shqyrtimit të proceseve të rishikimit të vendimit, autoritetet realizojnë në nivelin më maksimal të mundshëm një baraspeshë ndërmjet interesave të ankuesit dhe nevojës për të siguruar efektivitetin e sistemit të drejtësisë penale, duke respektuar në këtë mënyrë nenin 6 [para.55]; se gabimet e autoriteteve shtetërore duhet t'i shërbejnë të pandehurit [para.58]; dhe se lejimi i kërkesës së prokurorit nuk vendos një baraspeshë ndërmjet interesit të ankuesit dhe nevojës për të siguruar efektivitetin e sistemit të drejtësisë penale [para.59].

Vendimi Xheraj kundër Shqipërisë i GJEDNJ-së vlerësohet si shkak i ri kushtetues në dritën që Kushtetuta i jep të drejtës ndërkombëtare në përgjithësi si dhe KEDNJ-së e vendimeve të GJEDNJ-së, në veçanti. Në bazë të nenit 32 të KEDNJ-së, GJEDNJ-ja ka juridiksion të shqyrtojë të gjitha çështjet për interpretimin dhe zbatimin e KEDNJ-së. Ky nen i lexuar bashkërisht me nenin 46 të KEDNJ-së, parashikon detyrimin e shteteve palë në KEDNJ për të zbatuar të gjitha vendimet detyruese të GJEDNJ-së.

Gjykata Kushtetuese (Gjykata) ka pranuar më parë se Kushtetuta në nenet e saj 5, 116 dhe 122 parashikon se Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të, duke i radhitur marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, të cilat përbëjnë pjesë të sistemit të brendshëm juridik, në hierarkinë e akteve normative që kanë fuqi përpara ligjeve. KEDNJ-ja është një nga këto marrëveshje ndërkombëtare, të cilën Shqipëria e ka nënshkruar dhe ratifikuar (*shih vendimin nr. 65/1999 të Gjykatës Kushtetuese*).

Gjykata ka theksuar se Konventa e Vjenës për të Drejtën e Traktateve, e 23 majit 1969, përcakton dy kritere kryesore në sferën e zbatimit të traktateve ndërkombëtare: parimin e *pacta sunt servanda* (neni 26), sipas të cilit çdo traktat në fuqi është detyrues për palët dhe duhet të zbatohet prej tyre në mirëbesim dhe parimin se një palë nuk mund të përdorë dispozitat e së drejtës së brendshme si justifikim për pamundësinë e saj për të zbatuar një traktat (neni 27) (*Vendimi nr.15/2010 i Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 44*).

Neni 122 i Kushtetutës parashikon se çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të. KEDNJ-ja, përveçse është një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar, drejtpërdrejt e zbatueshme ose me efekt të drejtpërdrejtë, ka edhe një status të veçantë në bazë të nenit 17/2 të Kushtetutës, i cili përcakton se kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në KEDNJ. Pra, Kushtetuta i jep katalogut të të drejtave, të parashikuara në KEDNJ, statusin e standardit minimal ose të emëruesit më të vogël të përbashkët, për sa i takon kufizimeve të të drejtave dhe lirive të shprehura në Kushtetutë. Kjo është arsyeja që edhe Gjykata, në mënyrë të vazhdueshme në jurisprudencën e saj u referohet vendimeve të GJEDNJ-së, duke pranuar efektin e drejtpërdrejtë të këtyre vendimeve në interpretim të standardeve kushtetuese për të drejtat e njeriut, veçanërisht në kuptim të standardit të procesit të rregullt ligjor, parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës.

Pakica çmon se vendimet e GJEDNJ-së kanë vlerën e tyre në dy aspekte që lidhen me natyrën detyruese dhe me mënyrën e zbatimit të tyre në sistemin e brendshëm. Fuqia detyruese e këtyre vendimeve përcaktohet drejtpërdrejt nga KEDNJ-ja. Në çështjen *Verein Gegen Tierfabriken Schweiz (VgT) v. Zvicrës* (n3. 2) të datës 30.6.2009 GJEDNJ-ja sqaron parimet që rregullojnë zbatimin e vendimeve të saj, duke i vënë theksin zbatimit efektiv të këtyre vendimeve. GJEDNJ-ja shprehet se, sipas kërkesave të nenit 46 të KEDNJ-së, një shtet palë, për të cilin GJEDNJ-ja është shprehur se ka shkelur KEDNJ-në ose protokollin e saj, ka detyrimin që të veprojë në përputhje me vendimin e GJEDNJ-së në çdo çështje ku është palë. Me fjalë të tjera, një dështim tërësor ose i pjesshëm i ekzekutimit të vendimit të GJEDNJ-së lind përgjegjësinë ndërkombëtare të shtetit. Shteti në fjalë ka detyrimin jo vetëm të shlyejë dëmin material ndaj personave të interesuar, por edhe të marrë masa individuale dhe/ose, nëse është e përshtatshme, masa të përgjithshme në rendin e vet ligjor, që t'i japë fund shkeljes së gjetur nga gjykata dhe rregullimit të pasojave të shkeljes, me qëllimin që kërkuar të rikthehet, për aq sa është e mundur, në gjendjen që ishte para se të bëhej shkelja (*Vendimi i GJEDNJ-së Scozzari dhe Giunta v. Italisë* [GC], nos. 39221/98 dhe 41963/98, § 249, ECHR 2000-VIII, dhe *Assanidze v. Gjeorgjisë* [GC], no. 71503/01, § 198, ECHR 2004-II). GJEDNJ-ja pranon se, nën vëzhgimin e Komitetit të Ministrave, shteti i paditur në parim mund t'i zgjedhë vetë mjetet për të

përmbushur detyrimet sipas nenit 46/1 të KEDNJ-së, me kusht që mjetet të jenë në përputhje me konkluzionet e vendimit të GJEDNJ-së (Vendimet e GJEDNJ-së *Scozzari dhe Giunta*, § 249, dhe *Lyons dhe të tjerët*). Megjithatë, në disa raste të veçanta GJEDNJ-ja e ka gjetur të dobishme që t'i tregojë shtetit të paditur llojin e masave që mund të merren për t'i dhënë fund shkeljes (*Öcalan v. Turqisë*, no. 46221/99, § 210 *in fine*, ECHR 2005-IV; dhe *Popov v. Ruses*, no. 26853/04, § 263, 13 korrik 2006). Në disa raste, natyra e shkeljes nuk lë asnjë rrugëdalje për masat që duhet të merren (*Assanidze*, më lart, § 202). Megjithatë, kur një individ është dënuar sipas procedurave të cilat kanë sjellë cenim të kërkesave të nenit 6 të KEDNJ-së, GJEDNJ-ja mund të tregojë që rigjykimi ose rihapja e çështjes, nëse kërkohet, përfaqëson në parim një mënyrë të përshtatshme për rregullimin e shkeljes (*Gençel v. Turqisë*, no.53431/99, § 27, 23 tetor 2003; *Öcalan*, § 210; dhe *Claes dhe të tjerët v. Belgjikës*, nos.46825/99, 47132/99, 47502/99, 49010/99, 49104/99, 49195/99 dhe 49716/99, § 53, 2 qershor 2005). Kjo është në përputhje me udhëzimet e Komitetit të Ministrave, i cili në Rekomandimin R (2000) 2 i ka bërë thirrje shteteve palë të KEDNJ-së që të përfshijnë mekanizma në nivel vendor për rishqyrtimin ose rihapjen e çështjes, me kusht që kjo masë të përfaqësojë “mjetin më të efektshëm, në mos të vetmin për arritjen e *restitutio in integrum*”.

Pakica vlerëson se në rastin e paraqitur nga kërkuesi Xheraj para Gjykatës Kushtetuese, pretendimi bazë ka të bëjë me cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor (neni 6/1 i KEDNJ është drejtpërdrejtë i zbatueshëm), cenim i cili vjen si pasojë e moszbatimit të vendimit të GJEDNJ-së në favor të kërkuesit. Çështja e kërkuesit duhet të vlerësohet në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga Kushtetuta në bazë të neneve 5, 17/2, 122 dhe qëndrimit që ka mbajtur Gjykata se një mungesë ligjore nuk e shlyen shtetin nga detyrimi ndërkombëtar për të zbatuar një vendim gjyqësor. Në përputhje me këtë interpretim të përgjegjësisë ndërkombëtare të shtetit, të parimit *pacta sunt servanda*, epërsisë së normës ndërkombëtare ndaj legjislacionit të brendshëm dhe efektit të drejtpërdrejtë të KEDNJ-së, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk mund të citojë një normë të Kodit të Procedurës Penale (mungesën e shkaqeve sipas nenit 450), si arsye për të mos zbatuar vendimin e GJEDNJ-së, i cili është i detyrueshëm për zbatim për Shqipërinë. Pra, dispozitat e së drejtës së brendshme nuk mund të përdoren si justifikim për të mos përmbushur një detyrim ndërkombëtar që, në rastin konkret, lidhet me detyrimin e shtetit shqiptar për të mbrojtur të drejtën kushtetuese të kërkuesit, për një proces të rregullt ligjor për shkak të shkeljes së parimit të sigurisë juridike. Ky detyrim i shprehur në vendimin e GJEDNJ-së ka epërsi ndaj vendimit të Gjykatës së Lartë, i cili është në kundërshtim me të.

Pakica është e mendimit se rigjykimi, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, nuk është një mjet i efektshëm, për të garantuar ashtu siç kërkon GJEDNJ-ja, *restitutio in integrum* për kërkuesin, për aq kohë sa vetë Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në bazë të rregullave procedurale, e kthen çështjen për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë. Çështja objekt shqyrtimi ka veçoritë e veta. GJEDNJ-ja ka gjetur që vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr.417, datë 20.6.2001 ka cenuar parimin e sigurisë juridike, duke pranuar kërkesën e prokurorit për rivendosje në afat. Pra, është e qartë se ky proces penal ndaj kërkuesit nuk mund të konsiderohet se është në përputhje me KEDNJ-në. Pakica vlerëson se pasojat e këtij procesi të parregullt do të ndreqeshin duke realizuar *restitutio in integrum* (përfshi dëmshpërblimit) vetëm pas shfuqizimit të vendimit nr.417, datë 20.6.2001 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe shfuqizimit të vendimit të po kësaj Gjykate të vitit 2010.

Në bazë të nenit 132 të Kushtetutës, Gjykata ka të drejtën e shfuqizimit të akteve që shqyrton, ndërsa ligji nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, në nenin 77 të tij parashikon që Gjykata shfuqizon aktet dhe ia dërgon për shqyrtim gjykatës përkatëse. Për rastin në shqyrtim, në interpretim të Kushtetutës, të KEDNJ-së, të jurisprudencës së GJEDNJ-së dhe në zbatim të parimit të zbatimit të efektshëm të vendimeve të GJEDNJ-së, në respektim të *restitutio in integrum*, Gjykata duhet të pranonte në tërësi kërkesën e paraqitur nga Xheraj dhe të shfuqizonte të dy vendimet e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, për të vlerësuar pranimin ose jo të kërkesës për rishikim, jo vetëm që zvarrit një proces të evidentuar tashmë nga GJEDNJ-ja si një proces i parregullt ligjor, por nga ana tjetër nuk e identifikon Gjykatën Kushtetuese si një mjet efektiv për individin.

Anëtarë: Admir Thanza, Sokol Berberi, Sokol Sadushi.